



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Fondi i Sigurimeve Shëndetësore

RAPORTI VJETOR 2019

Fondi i Sigurimeve Shëndetësore

Prishtinë, Maj 2020

Tabela e përmbajtjes

Fjala Hyrëse e Kryesuesit të Bordit Drejtues të Fondit.....	3
Fjala Hyrëse e Drejtorit Fondit	5
Anëtarët e Bordit Drejtues të Fondit.....	7
Aktivitetet e Bordit Drejtues të Fondit.....	8
Vizioni, Misioni dhe Vlerat themelore.....	9
Përmbledhje ekzekutive.....	11
Qeverisja.....	13
1. Sistemi i kontrollit të brendshëm.....	13
1.1. Planifikimi strategjik.....	13
1.2. Legjislacioni.....	15
1.3. Komunikimi dhe raportimi.....	17
1.4. Auditimi	18
2. Raporti i ekzekutimit të buxhetit.....	20
2.1. Burimet njerëzore.....	20
2.2. Menaxhimi i buxhetit.....	21
2.3. Menaxhimi i pasurisë.....	26
2.4. Menaxhimi i obligimeve.....	27
3. Programi i trajtimeve mjekësore jashtë ISHP-ve.....	29
3.1. Trajtimet mjekësore jashtë ISHP-ve.....	29
3.2. Pagesat për trajtimet mjekësore jashtë ISHP-ve.....	31
3.3. Procesi i barazimeve me spitalet private.....	32
4. Parapërgatitja për kontraktimin e shërbimeve shëndetësore.....	35
5. Shërbimet farmaceutike.....	36
6. Sistemet e informacionit.....	37
7. Asistenca e jashtme	42
7.1. Projekti i Shëndetësisë Kosovare.....	42
7.2. AOK.....	43
7.3. Lux-Dev.....	43
Shtojca I – Objektivat dhe aktivitetet për vitin 2020.....	44
Shtojca II – Pasqyrat financiare për vitin 2019.....	46
Shtojca III – Struktura Organizative.....	67

Fjala Hyrëse e Kryesuesit të Bordit Drejtues të Fondit

Të nderuar,

Kam kënaqësinë të prezantoj Raportin vjetor për vitin 2019, i cili përtej sfidave me të cilat jemi përballur, qartas dëshmon se Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, dita ditës, po formësohet si organizatë e veçantë buxhetore, si periudhë tranzitore, me të gjithë parametrat e menaxhimit efikas, transparent dhe llogaridhënës.

Në përputhje me mandatin ligjor të bazuar në Ligjin për Sigurime shëndetësore Nr. 04/L-249 dhe Statutin e Fondit të Sigurimeve shëndetësore, Bordi Drejtues ka ushtruar kompetencat e veta në funksion hartimit të politikave orientuese, mbikëqyrjes së veprimtarisë së Fondit dhe ka siguruar që sistemet e kontrollit të brendshëm të jenë në pajtim me parimet e Menaxhimit të Financave Publike në sektorin publik.

Viti 2019 u karakterizua nga disa hapa të rëndësishëm në drejtim të funksionalizimit të plotë të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Janë bërë përgatitje të gjithmbarshme për një sistem efikas të sigurimit shëndetësor, që për qëllim parësor ka krijimin e një themeli të fortë që do të sigurojë se të gjithë qytetarët e siguruar të kenë qasje në kohë në shërbime shëndetësore.

Ky ishte një vit kur bëmë hapa të rëndësishëm në drejtim të plotësimit të parakushteve themelore për grumbullimin e premieeve, konsolidimin e Sistemi Informativ të Fondit dhe prezantimin e E-Recetës. Po kaq me rëndësi ishin edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me të gjitha institucionet relevante, të cilat përbëjnë hallka të rëndësishme të mekanizmit funksional të Sistemit të Informimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Të gjitha këto, dhe shumë të tjera, përbëjnë një bazament solid mbi të cilin do të ndërtojmë të ardhmen e institucionit.



*Krijimi i një
institucioni
kredibil i cili
me potencialin
e tij siguron
përmbushjen e
nevojave të
qytetareve për
shërbime
shëndetësore.*

Në vijim të këtyre që u thanë më sipër, ne tashmë kemi nisur punën në hartimin e një plani strategjik zhvillimor trevjeçar të Fondit, përmes të cilit do të vendosim konturat e orientimeve strategjike dhe zhvillimit organizativ për vitet në vijim. Përmes këtij plani synojmë që Fondi të formësohet si një institucion me kompetencë profesionale, administrative dhe organizative, i aftë që të ushtrojë me efikasitet të plotë të gjitha kompetencat, përgjegjësitë dhe obligimet që burojnë nga korniza ligjore për sigurimet e detyrueshme shëndetësore në Kosovë.

Vitin që vjen, ne do të bëjmë më të mirën tonë që të përafrohemi drejt funksionalizmit të sigurimeve shëndetësore, si dhe angazhimin maksimal të përfitimit nga donatorët, qoftë përmes mbështetjes financiare ashtu edhe përmes ekspertizës teknike dhe profesionale. Ekspertiza e Fondit gjerman të sigurimeve, Bankës Botërore dhe Projektit të Luksemburgut është një dëshmi e qartë se në rrugëtimin tonë nuk do të jemi vetëm.

Në fund, dua të falënderoj Ministrinë e Shëndetësisë, Anëtarët e Bordit Drejtues, Drejtorin e Fondit si dhe të donatorët, hisedarët dhe mbështetësit tanë, të cilët me mbështetjen dhe kontributin e tyre na i bëjnë më të arritshme synimet dhe objektivat tonë.

Prishtinë, 27 maj 2020

Xhevat Zejnullahu

Kryesues i Bordit Drejtues të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore



Fjala Hyrëse e Drejtorit të Fondit

Të nderuar anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit,

Kam kënaqësinë që të paraqes Raportin vjetor të punës së Fondit të Sigurimeve Shëndetësore për vitin 2019, i cili përtej sfidave me të cilat u përballëm, manifestoi një rritje të qenësishme në drejtim të funksionalizimit të plotë të sigurimeve shëndetësore.

2019-ta ishte një vit me një plan ambicioz në shumë drejtime që për synim parësor kishte plotësimin e parakushteve themelore për funksionalizimin e plotë të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore në vitin pasues (2020). Një ambicie e tillë domosdoshmërisht kërkonte edhe një qasje serioze dhe kulturë organizative të orientuar drejt rezultateve të parapërcaktuara të mbështetur, mbi të gjitha, në një administrim efikas, transparencë dhe llogaridhënie. Në funksion të kësaj, paralelisht me veprimtaritë tona për përmbushjen e synimeve, është instaluar edhe një mekanizëm efikas për monitorimin dhe vlerësimin e realizimit të aktiviteteve të parapara me plan. Raportet shteruese analitike në baza tremujore janë një element i rëndësishëm në këtë drejtim.

Në aspektin e strukturimit organizativ, kemi arritur që t'i plotësojmë shumicën e pozitave vakante në përputhje me rregulloren aktuale për organizimin dhe sistematizim, kurse përmes Projektit të Shëndetësisë Kosovare kemi siguruar vazhdimësinë e mbështetjes teknike dhe profesionale në fushat më vitale, si: financat, legjislacioni dhe teknologjia informative, kurse është aranzhuar edhe ekspertiza në fushën e informimit dhe bashkëpunimit. Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në këtë drejtim është se është siguruar lokacioni për ndërtimin e objektit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, si dhe është përfunduar plani ideor i objektit. Aktualisht jemi në proces të hartimit të planit strategjik zhvillimor trevjeçar, përmes të cilit do të vendosim konturat e zhvillimit organizativ dhe orientimeve strategjike për vitet që vijnë.



“Krijimi i një institucioni kredibil i cili siguron trajtimin e barabartë të personave të siguruar dhe zgjidhjen e nevojave të tyre në kohë, me cilësi të mirë dhe kosto-efektive”

Hapa shumë të rëndësishëm janë bërë edhe në kompletimin e infrastrukturës së teknologjisë informative duke përfshirë edhe vendosjen dhe konfigurimin e serverëve, si dhe janë zhvilluar të gjithë softuerët të cilët sigurojnë që proceset operative të Fondit të kryhen në mënyrë sa më efikase dhe ekonomike.

Është implementuar platforma e Sistemit të Informimit të Fondit, sistem me të cilin janë përmbushur shumica e kriterëve për mbledhjen e premieeve. Integrimi i të dhënave midis sistemeve (me shtatë institucionet relevante) është thelbësor për centralizimin e informacionit për vendimmarrje dhe transparencë. Integrimi efektiv siguron që informacionet e rëndësishme të sigurohen në një kohë të pranueshme, raporte konsistente dhe të integruara dhe një transparencë fiskale në përputhje me financat publike.

Trajtimet mjekësore jashtë institucioneve publike shëndetësore të Kosovës gjatë vitit 2019 ishin aktiviteti qendror i Fondit. Kam kënaqësinë që në këtë drejtim kemi shfaqur një performancë të admirueshme, e për më tepër, kemi bërë një punë të madhe edhe në barazimet e transaksioneve, me identifikuar mjete të lira 383,222€ dhe jemi në proces të barazimeve edhe më 24 institucione tjera shëndetësore private me të cilat kishim 3,451 transaksione.

Po ashtu, gjatë vitit 2019, janë plotësuar shumica e kriterëve të përcaktuara për grumbullimin e premieeve. Fondi i Sigurimeve Shëndetësore ka mbështetur trajnimin e 903 farmacistëve të licencuar në përdorimin e E-Recetës.

Me gjithë të arriturat e përmendura më sipër, jemi përballur me disa sfida në realizimin e objektivave, përfshi këtu plotësim/ndryshimin e legjislacionit, përgatitjen dhe finalizimin e listës së barnave jashtë-spitalore (më çmime) të cilat do të paguheshin nga Fondi, si dhe komunikimit me publikun qoftë përmes kampanjave informuese ose formave tjera më qëllim të rritjes së besimit nga ana e publikut. Të gjitha këtyre i është kushtuar një vëmendje e veçantë dhe ato janë adresuar në planin e veprimit për vitin 2020.

Prishtinë, 27 maj 2020

Fatmir Plakqi

Drejtore i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore



Anëtarët e Bordit Drejtues të Fondit



Xhevat Zejnullahu
Kryesues i Bordit Drejtues të Fondit
Përfaqësues i Ministrisë së Financave



Naim Bardiqi
Anëtar i Bordit Drejtues të Fondit
Përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë

Murat Berisha

Anëtar i Bordit Drejtues të Fondit
Përfaqësues i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës



Rezart Halili
Anëtar i Bordit Drejtues të Fondit
Përfaqësues i Odës së Profesionisteve Shëndetësor

Naim Ismaili

Anëtar i Bordit Drejtues të Fondit
Përfaqësues i Drejtorateve të Shëndetësisë të Asociacionit të Komunave të Kosovës



Izedin Bytyqi
Anëtar i Bordit Drejtues të Fondit
Përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

* Izedin Bytyqi, më datë 15.02.2020, ka dhënë dorëheqje nga funksioni i Anëtarit të Bordit Drejtues.

Muhamedali Kodra

Anëtar i Bordit Drejtues të Fondit
Përfaqësues i Shoqatave të Pacienteve



Aktivitetet e Bordit Drejtues të Fondit

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-249 për Sigurimet Shëndetësore, Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 11/42 të datës 19.04.2018 ka emëruar Bordin Drejtues të Fondit.

Bazuar në kompetencat e përcaktuara me Ligjin për Sigurime shëndetësore Nr. 04/L-249, dhe me Statutin e Fondit, Bordi Drejtues kanë mbikëqyrë veprimtarinë e Fondit, ka shqyrtuar dhe aprovuar raportet e rregullta, ka siguruar transparencën dhe ka siguruar që sistemet e kontrollit të brendshëm të jenë në pajtim me parimet e Menaxhimit të Financave Publike në sektorin publik.

Gjatë vitit 2019, Bordi Drejtues kishte mbajtur gjithsej 15 takime të rregullta në të cilat janë nxjerrë vendime, konkluzione dhe rekomandime, të prezantuara në vijim:

- Aprovimi i Planit të punës së Fondit për vitin 2019;
- Aprovimi i Raportit vjetor të Fondit për vitin 2018;
- Përzgjedhja e Kryesuesit të Bordit Drejtues të Fondit me mandat një vjeçar duke filluar nga date 03.05.2019;
- Miratimi i Rregullores së Procedurave të punës së Bordit;
- Shqyrtimi i Raportit tremujor të punës së Fondit për periudhën janar - mars (TM1);
- Themelimi i Komitetit të Auditimit të Fondit për Sigurimet Shëndetësore;
- Shqyrtimi i Raportit tremujor të punës së Fondit për periudhën prill – qershor (TM2);
- Dërgimi i kërkesës përmes Ministrisë së Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës për fillim e procedurave për hartimin e një strategjie për sigurime shëndetësore;
- Vendim, për angazhimin e një eksperti ndërkombëtar për mbështetjen e punës së Bordit; si dhe
- Shqyrtimi i Raportit tremujor të punës së Fondit për periudhën korrik – shtator (TM3).

Bordi Drejtues i Fondit mbetet i angazhuar në realizimin e plotë të detyrave dhe përgjegjësi të cilat i janë përcaktuar me Ligjin për Sigurime shëndetësore Nr. 04/L-249 dhe Statutin e Fondit të Sigurimeve shëndetësore.

Vizioni, Misioni dhe Vlerat themelore



Vizioni

Krijimi i qëndrueshmërisë financiare e cila siguron përmbushjen e nevojave të qytetareve për shërbime shëndetësore.

Misioni

Misioni i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore është të jetë një institucion i besueshëm dhe në zhvillim të përhershëm, i aftë që të përmbushë funksionet e veta me përgjegjësi, integritet, përkushtim, profesionalizëm dhe transparencë shembullore, përmes aplikimit të praktikave më të mira, aplikimit të inovacionit teknologjik, efikasitetit në ofrimin e shërbimeve dhe qëndrueshmërisë financiare si një garanci për mbrojtje shëndetësore me kosto të përballueshme për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë pa përjashtim.



Vlerat themelore të Fondit



Synimet

Synojmë që të kemi zhvillim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, duke u mbështetur në punonjës kompetentë dhe të orientuar drejtë rezultateve.

Transparenca dhe llogaridhënia

Të jemi të besueshëm, të hapur dhe të afërt. Vendimmarrja të jetë transparente dhe e vëmendshme ndaj të tjerëve.



Bashkëpunimi

Te krijojmë një atmosferë besimi brenda institucionit tonë dhe në marrëdhëniet me partnerët dhe klientët tanë.

Përmbledhje ekzekutive

Ky Raport në mënyrë të përmbledhur përmban veprimtaritë më të rëndësishme të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore (me tutje Fondi) përgjatë vitit kalendarik 2019, dhe brenda vetes përfshin të arriturat, sfidat që mbesin për t'u adresuar, si dhe projeksionet dhe planet strategjike për funksionalizimin e plotë të Fondit në një afat të shkurtër.

Thënë me pak fjalë, viti që lamë prapa u karakterizua nga një sërë masash dhe veprimesh që synim parësor kishin përgatitjet e strukturuar për funksionalizimin e plotë të Fondit. Përgatitjet për mbledhjen e premiumeve, konsolidimi i Sistemit Informativ të Fondit, marrëveshjet bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat relevante, puna në ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në legjislacionin primar dhe sekondar, konsolidimi i burimeve njerëzore, risitë në praktikën e menaxhimit, monitorimit dhe raportimit, dhe fuqizimi i aplikimit të teknologjisë informative në funksionit të administrimit efikas të veprimtarive të Fondi ishin disa nga orientimet strategjike në realizimin me sukses të objektivave të parashtruar.

Nga këndvështrimi përmbajtjesor, raporti është i strukturuar në shtatë (7) seksione, të cilat pasohen nga tre (3) shtojca.

Në seksionin e parë, *Qeverisja dhe sistemi i kontrollit të brendshëm*, janë paraqitur veprimtaritë e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore në funksion të krijimit të një kulture organizative që karakterizohet me një administrim efikas, sistemi të kontrollit të brendshëm, transparencë dhe llogaridhënie. Në këtë seksion ofrohen të dhëna mbi planifikimin strategjik, legjislacionin, komunikimin dhe raportimin, si dhe aspekte që ndërlidhen me veprimtaritë e auditimit.

Seksioni i dytë i raportit, *Ekzekutimi i buxhetit*, ofron një shumësi të dhënash të detajuara mbi potencialin buxhetor dhe administrimin e tij në dritën e organizimit të burimeve njerëzore, menaxhimit të buxhetit, aktiviteteve të prokurimit, menaxhimit të pasurisë dhe menaxhimit të obligimeve të Fondit.

Seksioni i tretë i raportit, *Programi i Trajtimeve Mjekësore Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike*, paraqet një pasqyrë të zgjeruar të trajtimeve mjekësore jashtë institucioneve shëndetësore publike, si aktivitetin qendror të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore në momentin e dhënë. Ky seksion ofron të dhëna të detajuara dhe të kategorizuara mbi trajtimet mjekësore jashtë institucioneve publike, pagesat si dhe procesin e barazimeve, si një aktivitetet shumë të rëndësishëm në rikuperimin e fondeve të pashfrytëzuara që do të vihen në dispozicion të pacientëve të tjerë.

Në seksionin e katërt të Raportit është paraqitur një *përmbledhje kumulative e parapërgatitjeve për kontraktimin e shërbimeve shëndetësore* duke përfshirë përvojat e mira të vendeve të rajonit, përgatitjen e draft dokumenteve kontraktimit, përgatitjet për themelimin e komisioneve teknike dhe profesionale për efekte të kontraktimit, dhe informacione të tjera relevante që ndërlidhen me këtë veprimtari.

Seksioni i pestë, *Shërbimet farmaceutike*, ofron një pasqyrë të zgjeruar të ri-formatimit të aktiviteteve që ndërlidhen me shërbimet farmaceutike në dritën e ndryshimeve që rezultuan me largimin e barnave nga buxheti i Fondit dhe planit të ri të aktiviteteve në drejtim të përgatitjes dhe finalizimit të listës së barnave jashtë-spitalore (më çmime) të cilat do të paguheshin nga Fondi.

Seksioni i gjashtë, *Sistemet e Informacionit*, ofron një pasqyrë të zgjeruar të veprimtarisë shumë të vëllimshme të Fondit në drejtim të krijimit të politikave, procedurave dhe planifikimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI), prokurimin dhe kontratat e TI-së, sigurimin e infrastrukturës harduerike dhe softuerike dhe automatizimin e proceseve për të gjitha sistemet të informacionit brenda Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Seksioni shtatë dhe i fundit, *Asistenca e Jashtme*, në mënyrë të përmbledhur pasqyron bashkëpunim voluminoz që Fondi i Sigurimeve Shëndetësore ka pasur me projektet dhe organizatat mbështetëse në funksion të përfitimit nga mbështetja teknike dhe profesionale e ofruar përmes tyre. Me theks të veçantë janë paraqitur aktivitetet e përbashkëta me Projektin e Shëndetësisë Kosovare, bashkëpunimin e ekspertët e fondit gjerman të sigurimeve AOK dhe projektin e financuar nga Lux Dev.

Raporti përmbyllet me tre shtojca në të cilat janë paraqitur dokumentet më thelbësore që plotësojnë të dhënat e ofruara në seksionet e rregullta. Këto shtojca nominalisht janë: (1) Objektivat dhe aktivitetet për vitin 2019, (2) Pasqyrat financiare, dhe (3) Struktura organizative.

Qeverisja

1. Sistemi i kontrollit të brendshëm

Fondi ka krijuar një sistem qeverisës duke përfshirë proceset, strukturat dhe veprimet e zbatuara të cilat mundësojnë sigurimin e qëllimeve të përgjithshme - rezultatet e synuara për qytetarët.

Proceset e rishikuara në kuadër të Fondit mundësojnë kontrolle efikase për adresimin e rreziqeve dhe ofrimin e sigurisë së arsyeshme lidhur me arritjen e rezultateve në realizimin e objektivave të Fondit.

Indikatorët matës për krijimin e një sistemi të mirë qeverisës janë: planifikimi strategjik, legjislacioni, komunikimi dhe raportimi, si dhe rishikimi/auditimi i proceseve nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm.

1.1. Planifikimi strategjik

Në muajin nëntor të vitit 2016, Ministria e Shëndetësisë ka hartuar Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë për vitet financiare 2017-2021. Në kuadër të saj janë paraparë tri (3) objektiva strategjike, si:

- Ruajtja dhe përparimi i shëndetit;
- Sigurimi i Financimit të Qëndrueshëm Shëndetësor; dhe
- Riorganizimi i Sektorit të Shëndetësisë.

Për ta përmbushur objektivin e dytë “Sigurimi i Financimit të Qëndrueshëm Shëndetësor” të strategjisë sektoriale, Fondi ka hartuar Draft Planin Strategjik për Zhvillim Institucional për vitet 2020-2022, i cili paraqet hapat deri në funksionimin e plotë të Fondit si financues i vetëm i shëndetësisë në Kosovë¹. Ky plan strategjik pritet të finalizohet brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2020.

Vizioni i Fondit është të krijojë një qëndrueshmëri financiare e cila siguron përmbushjen e nevojave të qytetareve për shërbime shëndetësore, ndërsa misioni i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore është të jetë një institucion i besueshëm dhe në zhvillim të përhershëm, i aftë që të përmbushë funksionet e veta me përgjegjësi, integritet, përkushtim, profesionalizëm dhe transparencë shembullore, përmes aplikimit të praktikave më të mira, aplikimit të inovacionit teknologjik, efikasitetit në ofrimin e shërbimeve dhe qëndrueshmërisë financiare

¹ Ky dokument është draft dhe mund të ndryshohet deri në aprovimin e Bordit Drejtues.

si një garanci për mbrojtje shëndetësore me kosto të përballueshme për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë pa përjashtim.

Për të përmbushur vizionin dhe misionin, Fondi ka paraparë qëllimet kryesore si:

- Krijimi i qëndrueshmërisë financiare të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore;
- Krijimi dhe vazhdimësia e komunikimit ndërmjet sistemeve shëndetësore, përmirësimi i sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave;
- Krijimi dhe avancimi i vazhdueshëm i metodologjisë së pagesës së ofruesve të shërbimeve shëndetësore, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore; dhe
- Zhvillimi i qëndrueshëm institucional.

Me tej, Fondi ka planifikuar edhe kohën e realizimit për qëllimet e lartcekura. Brenda vitit 2020 janë planifikuar disa hapa, përfshirë kompletimin e legjislacionit, ristrukturimin dhe kompletimin e stafit përfshirë edhe zyrat regjionale, krijimin e sistemeve të teknologjisë informative, si dhe fillimin e mbledhjes së premie në tremujorin e fundit të vitit 2020, si bazë për krijimin e rezervës financiare të Fondit.

Gjatë vitit 2020, përkatësisht gjatë përgatitjes së Buxhetit të Kosovës për vitin 2021 fondet për shëndetësi pritet të barten në Fond në formë të transfereve e cila pritet të jetë rreth 3% e bruto prodhimit vendor². Kësaj përqindje me pas do t'i shtohen edhe premiumet, të cilat pritet të jenë rreth 2% e bruto prodhimit vendor si dhe të hyrat tjera. Si rezultat, të hyrat e Fondit do të jenë mbi 5% e Bruto Prodhimit Vendor, përqindje e afërt me vendet e rajonit.

Edhe përkundër krijimit të financimit të qëndrueshëm, financimi i shëndetësisë në vitin 2021 do të behet me një metodologji me të thjeshtë bazuar në 1/12 e buxhetit. Buxheti do të alokohet në periudha tremujore, përkatësisht në fillim të çdo tremujori. Gjatë vitit 2021 do të kryhen procedurat e kontraktimit, përfshirë kostimin e shërbimeve si dhe legjislacionin për kontraktim.

Pas vitit 2021, Fondi do të avancojë metodologjinë e pagesave të cilat mundësojnë zhvillimet në sistemin e kujdesit shëndetësor dhe mbështetjen e masave të rritjes së kujdesit të përqendruar tek pacienti dhe përdorimin e metodave të trajtimit që janë më ekonomike për pacientin. Metodologjia me e avancuar është përcaktimi i çmimeve bazuar në koston optimale të shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Përcaktimi i çmimit, nga ana tjetër, siguron një nxitje për ofrimin e shërbimeve me cilësi të duhur të pacientëve, duke pasur në konsideratë përdorimin e arsyeshëm të fondeve të sigurimit shëndetësor.

² Kërkesë sipas Draft Ligjit për Sigurime Shëndetësore, i cili është përgatitur nga grupi punues dhe pritet të dërgohet në Qeveri për procedim të mëtejshëm në Kuvendin e Kosovës.

1.2. Legjislacioni

Ligji Nr. 04/L-249 i Sigurimeve Shëndetësore, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 10 prill 2014, ka siguruar bazën ligjore për sigurimin shëndetësor në Republikën e Kosovës.

Me pas, me datë 08 dhjetor 2016, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë Statutin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore i cili ka përcaktuar organizimin, të drejtat, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e kryerjes së veprimtarisë, sipas këtij ligji.

Në përputhje të plotë me këto dy akte themeltare, Fondi edhe përgjatë vitit 2019 ka vijuar me aktivitetet tjera në përmbushje të kërkesave legjislative. Në këtë drejtim, Fondi ka vazhduar aktivitetet në përmbushje të Planit të Punës, edhe pse me resurse të limituara, ka arritur që të përmbushë në shkallë të kënaqshme obligimet e dala nga Plani i Punës.

Këto aktivitete, të zbatuara kryesisht nga Divizioni Ligjor, kanë përfshirë një gamë të gjerë të obligimeve duke filluar nga punët e përditshme teknike për sigurimin e ligjshmërisë në aktivitetet e Fondit, deri të dhënia e opinioneve ligjore apo kontributeve profesionale në hartimin e akteve nënligjore apo draft ligjit për sigurime shëndetësore.

Për me tepër, Divizioni Ligjor ka vazhduar së ndihmuari në aspektin organizativ dhe profesional edhe Bordin e Fondit si dhe ka asistuar Avokaturën Shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë në rastet kur Fondi ka qenë palë ndërgjyqësore. Siç u cek edhe më lartë, Fondi gjatë tërë vitit ka qenë i përqendruar në realizmin e planit vjetor të punës 2019, respektivisht në përpunimin e akteve normative dhe nën aktiviteteve që derivojnë nga ky plan.

Brenda vitit 2019 janë miratuar nga Bordi Drejtues aktet si në vijim:

- Kodi Etik i Fondit;
- Rregullorja për Punë dhe Përgjegjësitë Disiplinore në Vendin e Punës;
- Rregullorja e Brendshme për Vlerësimin e Performancës së Stafit; dhe
- Rregullorja për Procedurat e Punës së Bordit Drejtues të Fondit.

Gjatë vitit 2019 janë lidhur edhe shtatë (7) marrëveshje mirëkuptimi për shkëmbimin e të dhënave të cilat kontribuojnë në kompletimin e bazës së të dhënave për Sistemin e Informimit të Fondit, si:

- Është nënshkruar marrëveshje dhe procedurë standarde e operimit me Administratën Tatimore e Kosovës për shkëmbimin automatik të të dhënave të personave që paguajnë premiume;

- Është nënshkruar marrëveshje dhe procedurë standarde e operimit me Ministrinë e Shëndetësisë për shkëmbimin e të dhënave të regjistrit të institucioneve dhe personelit mjekësor, por të dhënat ende nuk janë të plota. Pritet që MSH të i kompletojë këto të dhëna dhe të validojë saktësinë e tyre;
- Është nënshkruar marrëveshje dhe procedurë standarde e operimit me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për shkëmbimin automatik të të dhënave për skemat sociale;
- Është nënshkruar marrëveshje dhe procedurë standarde e operimit me Agjencinë e Regjistrimit Civil për shkëmbimin automatik të të dhënave të qytetarëve të Kosovës;
- Është nënshkruar marrëveshje dhe procedurë standarde e operimit me Odën e Farmacistëve të Kosovës për shkëmbimin e të dhënave të farmacistëve të licencuar;
- Është nënshkruar marrëveshje dhe procedurë standarde e operimit me Agjencinë për Produkte dhe Pajisje Mjekësore për shkëmbimin automatik të të dhënave të barnatoreve të licencuara dhe barnave të autorizuar, por është në proces që të bëhet edhe kodifikimi unik i barnave; dhe
- Është nënshkruar marrëveshje me Bankën Qendrore e Kosovës për ndërlidhjen e sistemeve për transferin e pagesave dhe mbledhjen e të hyrave dhe premiumeve. Ndërlidhja e plotë pritët që të realizohet gjatë pjesës së parë të vitit 2020.

Përpos akteve të lartpërmendura, Fondi është në proces të përfundimit edhe të numri të madhe të aktiviteteve tjera. Ligji i Sigurimeve Shëndetësore është finalizuar nga grupi punues dhe është dërguar në kabinetin e ministrit për procedim të mëtejshëm. Përpos legjislacionit parësor, Fondi ka asistuar në grupe punuese për të ndryshuar/plotësuar edhe legjislacionin sekondar, përfshirë:

- Finalizimin e UA për përcaktimin e çmimeve për barna dhe pajisje medicinale;
- Draftimin e UA për përcaktimin e kriterëve për lirim nga pagesa e premiumeve, bashkë-pagesat dhe pagesat tjera për shërbime shëndetësore;
- Draftimin dhe dorëzimin e listës së shërbimeve bazike me çmimet testuese, si dhe finalizimin e formave të raportimit nga të gjitha institucionet shëndetësore në Fond;

- Finalizimin e Draft Udhëzimit Administrativ për Trajtime Mjekësore Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore (në pritje për procedim të mëtejshëm në Qeveri); dhe
- Puna në proces e ndryshimit të Rregullores për Organizimin dhe Sistematizim të Vendeve të Punës në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore; si dhe

Nxjerra e vendimeve për krijimin e komisioneve të ndryshme për zhvillimin e aktiviteteve të Fondit.

1.3. Komunikimi dhe raportimi

Në mars të vitit 2017, Ministria e Shëndetësisë ka hartuar Planin e Komunikimit për Sigurime Shëndetësore 2017-2021. Synimi parësor i këtij Plani është që të mbështesë procesin e reformimit të financimit të shëndetësisë, pjesë esenciale e të cilit është zbatimi i skemës së sigurimeve shëndetësore, përmes një komunikimi të integruar, të strukturuar dhe të kohshëm që në thelb ka informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë dhe vlerën e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore.

Thënë këtë, Plani i komunikimit është një instrument i rëndësishëm i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe institucioneve relevante në funksion të fuqizimit të mekanizmit për promovimin e sigurimeve shëndetësore, e për rrjedhojë edhe sigurimin e një mbështetje të gjerë në reformën shëndetësore. Përmes këtij plani është synuar që të krijohet një kulturë komunikuese me qytetarët si kontribuues, por edhe si përfitues i shërbimeve cilësore.

Në vijim të kësaj, në fund të vitit 2019, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore si entitet i pavarur institucional në organikën e vet ka integruar edhe Divizionin për Informim dhe Bashkëpunim, gjë që është pasuar edhe me përpilimin e detyrave dhe përgjegjësi të Divizionit për Informim dhe Bashkëpunim dhe rekrutimin e dy zyrtarëve përkatës. Përveç kësaj, në kuadër të Projektit të Shëndetësisë Kosovare është angazhuar edhe një konsulent i komunikimit dhe informimit, i cili do të përkujdeset për funksionalizimin e plotë të Divizionit dhe ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve përkatës në konceptimin, organizimin dhe administrimin e aktiviteteve me karakter të informimit dhe ndërgjegjësimin të publikut.

Në vijim të këtyre zhvillimeve, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore në planin e punës për vitin 2020 ka hartuar një objektiv specifik për zhvillimin e komunikimeve me mediat dhe publikun e gjerë me qëllim të informimit të plotë të të siguruarve si dhe promovimit të vlerave të Fondit. Në kuadër të këtij objekti, midis tjerash, janë paraparë një sërë aktiviteteve specifike, si: hulumtim analitik mbi nevojat e informimit, përgatitje e materialeve të nevojshme me

karakter informimi (broshura, seminare, spote dhe njoftime në faqen elektronike, etj.); si dhe organizimi e një fushate të gjerë dhe të strukturuar për informim dhe ndërgjegjësim publik.

Në funksion të organizimit dhe menaxhimit efikas, drejtuesit e Fondit në praktikën e punës dhe administrimit kanë instaluar praktika organizative që mundësojnë planifikim, bashkërendim dhe mbikëqyrje efikase. Në aspektin e komunikimeve të brendshme, Fondi ka ndërtuar një komunikim efektiv me punonjësit, duke ofruar mundësi për secilin punonjës të shprehet hapur si në nivelin hierarkik ashtu edhe brenda departamenteve për çështjet që lidhen natyrën e punës së tyre.

Drejtori i Fondit mban takime të rregullta me udhëheqësit e departamenteve, në të cilat diskutohet dhe raportohet lidhur me aktivitetet operative të realizuara si dhe për aktivitetet e planifikuara për periudhën e ardhshme. Më pas, udhëheqësit e departamenteve mbajnë takime me stafin e tyre të cilët informohen mbi çështjet kryesore lidhur me institucionin.

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësi, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Në funksion të kësaj është rritur cilësia e raportimeve periodike, të cilat janë në shërbim të vendimmarrjes më efikase dhe menaxhimit efikas të veprimtarisë së Fondit.

1.4. Auditimi

Fondi ju ka nënshtruar proceseve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm.

1.4.1. Auditimi i jashtëm

Auditimi i Jashtëm kryhet nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Gjatë vitit 2018, Fondi ishte pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë, andaj auditimi i jashtëm është kryer në kuadër të saj. Rekomandimet e dhëna për Fondin janë monitoruar në vazhdimësi deri në zbatimin e plotë të tyre.

Ndërsa auditimi financiar për vitin 2019 dhe auditimi i performancës për “Programin Trajtimet Mjekësore Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore” (auditim me kërkesë të Ministrit të Shëndetësisë dhe Menaxhmentit të Fondit) janë në proces të auditimit. Raporti financiar pritet të përfundohet brenda periudhës deri më 30 qershor 2020.

1.4.2. Auditimi i Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) është themeluar në fillim të muajit tetor të vitit 2018, me rekrutimin e udhëheqësit të kësaj njësie. Përgjatë kësaj periudhe kohore është përgatitur Statuti i njësisë, Kodi i etikës, Planet strategjike, si dhe planet vjetore të auditimit sipas kërkesave ligjore (Ligji për Kontrollin e Financave Publike).

Po ashtu, është formuar edhe Komiteti i Auditimit, i cili brenda vitit 2019 ka mbajtur tri (3) takime në të cilat janë miratuar dokumentet si: Statuti i Komitetit të Auditimit të Brendshëm, Plan Strategjik, Plan i Punës. Përpos miratimit të dokumenteve, janë shqyrtuar edhe raportet e auditimit dhe aktivitetet që lidhen me implementimin e rekomandimeve të dhëna në këto raporte.

Planet vjetore janë gjithëpërfshirëse me reflektim të rreziqeve të mundshme financiare dhe operative në kuadër të Fondit si dhe ofrojnë bazë të mjaftueshme për të ofruar siguri mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.

Plani vjetor për vitin 2019 ka përfshirë auditimin e fushave të cilat i ekspozohen me shumë rreziqeve si:

- Trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore;
- Financat dhe Shërbimet e Përgjithshme;
- Personelin; si dhe
- Shërbimet farmaceutike.

Të gjitha auditimet e planifikuara janë realizuar brenda vitit 2019 si dhe janë marrë masa të mjaftueshme drejtë implementimit të rekomandimeve. Deri me tani Menaxhmenti i Fondit ka zbatuar rekomandimet konform afateve të parapara.

Plani vjetor për vitin 2020 ka përfshirë gjithashtu edhe fushat të cilat i ekspozohen me shumë rreziqeve si:

- Trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore;
- Barazimet me Institucionet Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore;
- Financat dhe Shërbimet e Përgjithshme; dhe
- Prokurimi.

2. Raporti i ekzekutimit të buxhetit

2.1. Burimet njerëzore

Burimet njerëzore kanë krijuar një qasje të re të menaxhimit të burimeve njerëzore. Fokusi kryesor i tyre është drejtuar në zhvillim profesional të kapaciteteve njerëzore, ku përmes ngritjes së vazhdueshme profesionale të punonjësve synojmë të forcojmë kompetencën e stafit në punën e tyre profesionale.

Për vitin 2019 kanë përgatitur planin e trajnimeve i cili ka paraparë trajnimet bazike (për stafin e ri), si dhe trajnimet profesionale.

Më tutje, sipas buxhetit final ishte e paraparë të rritet numri i stafit nga 36 sa ishte në fund të vitit 2018 në 98 punonjës. Megjithatë, këtë e ka pamundësuar Rregullorja nr. 04.2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, sipas të cilës numri i stafit duhet të jetë 50 punonjës.

Gjatë vitit 2019 janë rekrutuar tetë (8) punonjës duke arritur numri në 44 punonjës, prej tyre:

- Në kuadër të Zyrës së Drejtorit të Fondit – 4 punonjës;
- Departamenti për Shërbime Shëndetësore – 10 punonjës;
- Departamenti për Shërbime Farmaceutike – 6 punonjës;
- Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme – 15 punonjës;
- Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Informacionit – 1 punonjës;
- Divizioni i Burimeve Njerëzore – 3 punonjës;
- Divizioni Ligjor – 3 punonjës;
- Divizioni i prokurimit – 1 punonjës; dhe
- Njësia e Auditimit të Brendshëm – 1 punonjës.

Përpos tyre, përmes Projektit të Shëndetësisë Kosovare (PShK) kanë vazhduar të angazhohen edhe pesë (5) konsulentë, të cilët mbulojnë fushën e financave, legjislacionit dhe TI-së.

Gjatë vitit 2019, për gjithë stafin e Fondit janë mbajtur trajnime bazike dhe profesionale për të siguruar ngritjen e vazhdueshme profesionale të tyre. Po ashtu, është kompletuar në tërësi sistemi elektronik për menaxhimin e dosjeve të personelit.

Me tutje, është hartuar planin vjetor i trajnimeve për vitin 2020, në bazë të të cilit janë planifikuar trajnime bazike dhe të avancuara. Qëllimi i këtyre trajnimeve është që personeli i Fondit të ruajë njohuritë rreth proceseve të punës, si dhe të avancojë njohuritë profesionale (kompetencat) përmes pjesëmarrjes në trajnime profesionale, punëtori, etj.

2.2. Menaxhimi i buxhetit

2.2.1. Buxheti fillestar dhe final i Fondit

Bazuar në Ligjin Nr. 06/L -133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Fondit i janë ndarë 8,697,583€.

Tabela nr.1. Buxheti fillestar i Fondin për vitin 2019

Shpenzimet / Departamentet	Administrata	Trajtimi Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore	Gjithsej buxheti për vitin 2019
Pagat dhe mëditjet	641,286		641,286
Mallrat dhe Shërbimet	1,060,137		1,060,137
Shpenzimet komunale	66,160		66,160
Subvencionet dhe transferet		6,000,000	6,000,000
Shpenzimet kapitale	930,000		930,000
Gjithsej	2,697,583	6,000,000	8,697,583

Nga tabela më lartë mund të shohim se nga gjithsej buxheti fillestar për vitin 2019 në vlerë 8,697,583€, vlera prej 6,000,000€, ose 69% e totalit të buxhetit, ishte ndarë për subvencione dhe transfere (programi - trajtime mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore), ndërsa pjesa tjetër për shërbimet administrative të Fondit.

Buxheti fillestar i ndarë për vitin 2019 për Trajtime Mjekësore Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike në shumën 6 mil € nuk mbulonte as obligimet e mbetura në fund të vitit 2018 për këtë program, të cilat ishin 7,170,229€.

Kjo vazhdon të jetë sfidë për Fondin sepse për çdo vit kalendarik për programin e Trajtimeve Mjekësore Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike aplikojnë rreth 1,500 pacientë dhe mesatarja e shpenzimeve vjetore është afro 12 mil €. Andaj obligimet e mbetura janë duke u rritur nga viti në vit.

Megjithatë, pas vendimeve të qeverisë: Nr.01/113 të datës 05.11.2019, si dhe Nr.01/115 të datës 17.12.2019, Fondi kishte kursime buxhetore në vlerë totale 1,856,326€ (paga dhe mëditje në vlerë 283,326€, mallra dhe shërbime në vlerë 700,000€, komunalitë në vlerë 30,000€, si dhe kapitale në vlerë 840,000€).

Ndërsa, po me të njëjtat vendime, Fondi ka përfituar 2,700,000€ në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, përkatësisht në programin Trajtime Mjekësore Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike.

Pas ndryshimeve buxhetore me vendimet e Qeverisë, buxheti i Fondit është rritur për 846,674€. Buxheti final pas ndryshimeve është paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela nr.2. Buxheti final i Fondit për vitin 2019

Shpenzimet / Departamentet	Administrata	Trajtimi Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore	Gjithsej buxheti për vitin 2019
Pagat dhe mëditjet	357,960		357,960
Mallrat dhe Shërbimet	360,137		360,137
Shpenzimet komunale	36,160		36,160
Subvencionet dhe transferet		8,700,000	8,700,000
Shpenzimet kapitale	90,000		90,000
Gjithsej	844,257	8,700,000	9,544,257


2.2.2. Shpenzimet në raport me buxhetin final

Tabela nr.3. Shpenzimet në raport me buxhetin final për vitin 2019

Emërtimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	Shpenzimet 2019	Realizimi i buxhetit në %
Paga dhe rroga	641,286	357,960	357,960	100%
Mallra dhe shërbime	1,060,137	360,137	269,304	75%
Shpenzime komunale	66,160	36,160	22,217	61%
Transfere dhe subvencione	6,000,000	8,700,000	8,699,979	100%
Shpenzime kapitale	930,000	90,000	61,804	69%
Gjithsej	8,697,583	9,544,257	9,411,265	99%

- **Paga dhe mëditje** - Fondi i alokuar me buxhetin fillestar ishte 641,286€, mirëpo në buxhetin final kjo kategori ishte rritur në 357,960€. Në fund të vitit buxheti i realizuar ishte 357,960€, ose shprehur në përqindje në shkallën 100%;
- **Mallra dhe shërbime** - Me buxhetin fillestar buxheti i miratuar për këtë kategori ishte 1,060,137€, mirëpo me vendime ky buxhet ishte reduktuar për 700,000€, duke reduktuar vlerën e buxhetit final në 360,137€. Buxheti final i shpenzuar ishte 269,304€, ose shprehur në përqindje në shkallën 75% të buxhetit final;
- **Shpenzimet komunale** - Me buxhetin fillestar buxheti i miratuar për këtë kategori ishte 66,160€, mirëpo buxheti final ishte reduktuar në 36,160€. Buxheti i realizuar në fund të vitit për këtë kategori ekonomike ishte 22,217, ose shprehur në përqindje 61%;
- **Subvencione dhe transfere** - Me buxhetin fillestar buxheti i miratuar për këtë kategori ishte 6,000,000€, mirëpo buxheti final ishte rritë për 2,700,000€, duke rrite vlerën e buxhetit final në 8,700,000€. Buxheti final i shpenzuar ishte 8,699,979€, ose shprehur në përqindje 100%; dhe
- **Shpenzimet kapitale** - Buxheti fillestar për këtë kategori ishte miratuar në shumën prej 930,000€, mirëpo me buxhetin final kjo kategori ishte reduktuar për 840,000€ duke rënë në 90,000€. Buxheti në këtë kategori ishte shpenzuar në vlerë 61,804€, ose shprehur në përqindje 69%.

Figura nr.1. Shpenzimet në raport me buxhetin final për vitin 2019



2.2.3. Shpenzimet e vitit 2019 në krahasim me ato të vitit 2018


Tabela nr.4. Shpenzimet e vitit 2019 në raport me ato të vitit 2018

Emërtimi	Shpenzimet 2018	Shpenzimet 2019	Diferenca në vlerë	Diferenca në %
Paga dhe rroga	216,242	357,960	141,718	40%
Mallra dhe shërbime	23,468,610	269,304	-23,199,306	-8,615%
Shpenzime komunale	6,959	22,217	15,258	69%
Subvencione dhe transfere	9,192,553	8,699,979	-492,574	-6%
Shpenzime kapitale	1,475,155	61,804	-1,413,351	-2,287%
Gjithsej	34,359,519	9,411,264	-24,948,255	-265%

Nga tabela me lartë vërehet se shpenzimet për vitin 2019 janë reduktuar për 265% në raport me vitin 2018, megjithëse reduktimi ishte si rrjedhojë e bartjes së buxhetit për barna në Shërbimin Spitalor, Klinik dhe Universitar të Kosovës. Në vijim do të paraqesim detajet e shpenzimeve sipas kategorive:

- **Paga dhe mëditje** - në këtë kategori shpenzimet në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018 janë rritur për 40%. Rritja e shpenzimeve ishte si rezultat i rritjes së stafit;
- **Mallra dhe shërbime** – në këtë kategori shpenzimet në vitin 2019 janë rënë dukshëm, e kjo si rrjedhojë e bartjes së buxhetit për barna në Shërbimin Spitalor, Klinik dhe Universitar të Kosovës;
- **Shpenzimet komunale** – në këtë kategori shpenzimet komunale janë rritur për 69%. Në vitin 2018, përkatësisht deri në muajin maj 2018, stafi i Fondit ishte i vendosur në objektin e Ministrisë së Shëndetësisë, andaj shpenzimet komunale ishin më të ulëta;
- **Subvencione dhe transfere** - në këtë kategori ka rënie të shpenzimit për 6% e kjo për shkak të mungesës së buxhetit në këtë kategori; si dhe
- **Shpenzime kapitale** – në këtë kategori ka rënie të shpenzimit për 2,287%. Shpenzimet e larta në vitin 2018 në këtë kategori ndërlidheshin me ndërtimin e spitalit të Ferizajt i cili ishte buxhetuar dhe shpenzuar nga kodi i buxheti i Fondit.

Figura nr.2. Shpenzimet në raport me buxhetin final për vitin 2019



2.2.4. Prokurimi

Fondi është ndarë si organizatë buxhetore me Ligjin e Buxhetit për vitin 2019. Meqenëse kishte vonesa deri në miratimin e buxhetit, fillimisht Fondi ka funksionuar në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë, bazuar në 1/12 e buxhetit të vitit paraprak. Pas ndarjes së Fondit si Organizatë Buxhetore, Prokurimet i ka kryer Ministria e Administratës Publike. Në vijim po shpalosim aktivitetet e prokurimit të realizuara për vitin 2019.

Tabela nr.5. Prokurimet e realizuara gjatë vitit 2019

Nr.	Aktiviteti i Prokurimit 2019	Vlera e parashikuar e kontratës	Vlera e Kontratës
1	Sigurimi i veturave	999	989
2	Publikimin në shtypin ditor	999	975
3	Shërbimet e përkthimit	5,000	4,898
4	Larja e veturave	900	296
5	Punimi i projekt-dizajnit për objekt	50,000	38,400
6	Furnizim me lule dhe piktura	999	958
7	Sigurimi i veturave	2,550	919
8	Mirëmbajtja higjienike e objektit	16,500	12,720
9	Furnizimi me pajisje të IT	400,000	398,646
10	Punimi i Projekt-dizajnit për objekt (Aneks)	2,804	2,377
11	Grirëse të letrave (shredder)	900	880
Gjithsej		481,651	462,058

Fondi në fund të vitit 2019 ka dorëzuar planin preliminar të prokurimit në Departamentin e Prokurimit në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike duke u bazuar në qarkoren e fundit buxhetore për vitin 2020, kurse me miratimin e buxhetit kemi dorëzuar planin final të prokurimit për vitin 2020.

2.3. Menaxhimi i pasurisë

Në fund të vitit 2018 është krijuar komisioni për inventarizim të pasurisë, i cili pas procesit të identifikimit/numërimit fizik të pasurisë ka hartuar raportin i cili është krahasuar me raportet e pasurisë për të identifikuar dhe eliminuar diferencat.

Më pas, pas miratimit të ligjit të buxhetit ku Fondi është ndarë si organizatë buxhetore e veçantë është krijuar një komision për transferimin e pasurisë nga Ministria e Shëndetësisë të Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, proces i cili ka përfunduar në kuadër të tremujorit të parë të vitit 2019.

Tabela nr.6. Pasuritë më 31 dhjetor 2019

Përshkrimi	Pasuritë më 31 dhjetor 2018	Pasuritë më 31 dhjetor 2019	Diferenca / Rritja e pasurisë
Pajisjet dhe inventari	89,847	241,821	151,974
Zhvlerësimi për vitin 2019	0	6,778	6,778
Pasuria neto pas zhvlerësimit	89,847	235,043	158,752

Pasuria e blerë në vitin 2018 në vlerë 89,847€, ishte transferuar në Fond në kuadër të tremujorit të parë të vitit 2019, ndërsa gjatë vitit 2019 janë rritur pasuritë e Fondit për 151,974€ (vlera bruto para zhvlerësimit). Në vijim janë shpalosur blerjet e pasurisë sipas periudhave tremujore, si:

- Në kuadër të TM2/2019 Fondi ka rritur pasuritë për 60,320€. Prej tyre 29,800€ për blerjen e automjetit nga granti qeveritar, ndërsa 30,520€³ janë nga huamarrja (pagesat janë bërë nga Ministria e Shëndetësisë, ndërsa pasuria është transferuar në Fond);
- Në kuadër të TM3/2019 prej projektit të huamarrjes janë blerë edhe tri (3) automjete në vlerë totale 60,350€; dhe
- Në TM4/2019 është bërë plani ideor për ndërtimin e objektit të Fondit në vlerë 31,304€.

Në fund të vitit 2019 është bërë edhe zhvlerësimi i pasurisë në vlerë 6,778€ dhe vlera neto e pasurisë pas zhvlerësimit është 235,043€.

³ PC, laptop, pajisje tjera elektronike.

2.4. Menaxhimi i obligimeve

Fondi ka krijuar një sistem të mirë të pagesave në pajtueshmëri të plotë me rregullat e Thesarit të Kosovës, duke filluar nga kontraktimi e deri te ekzekutimi i tyre. Secila faturë e pranuar fillimisht protokollohet, e më pas paguhet sipas rregullores në fuqi. Për të gjitha faturat e pa paguara mbahet një evidencë e veçantë, të cilat raportohen rregullisht në Thesar (Ministrinë e Financave).

Përkundër këtij procesi të rregullt të pagesave, në mungesë të buxhetit një shumë e konsiderueshme e obligimeve kanë mbetur të papaguara. Ato kryesisht lidhen me kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve, përkatësisht programin e trajtimeve mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore.

Me 31 dhjetor 2019 këto obligime ishin në vlerë 11,075,724€, ose janë rritur për 3,572,292€ në krahasim me fund vitin 2018, ku vlera e obligimeve ishte 7,503,432€.

Tabela nr.7. Obligimet më 31 dhjetor 2019

Kategoria Ekonomike	Obligimet me 31 dhjetor 2018	Obligimet me 31 dhjetor 2019	Diferenca / rritja e obligimeve
Mallra dhe Shërbime	56,854	984	(55,870)
Shpenzimet Komunale	4,355	-	(4,355)
Subvencionet dhe Transferet	7,170,229	11,074,740	3,904,511
Investimet Kapitale	271,994	-	(271,994)
Gjithsej	7,503,432	11,075,724	3,572,292

Përpos obligimeve të cilat janë të raportuara në Thesar (Ministrinë e Financave), Fondi ka edhe disa detyrime kontingjente.

Në fund të vitit 2019 janë rishikuar detyrimet kontingjente, përkatësisht janë bartur detyrimet kontingjente për barna në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, pasi që në vitin 2019 edhe buxheti për barna është transferuar në këtë institucion.

Detyrimet kontingjente pas rishikimit janë të prezantuara në tabelën në vijim.

Tabela nr.8. Detyrimet kontingjente më 31 dhjetor 2019

Paditësi	Përshkrimi	Vlera
R-B	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	10,000
B-S	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	2,500
R-I	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	3,878
H-R	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	11,000
A-Q	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	4,800
A-L	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	8000
R-B	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	900
E-H	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	6,000
Sh-T	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	4,000
Xh-H	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	3,000
I-I	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	8,000
B-A	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	8,500
D-M	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	2,615
D-M	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	8,400
S-B	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	1,400
A-O	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	13,560
H-O	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	9,492
P-D	Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	9,500
Gjithsej		115,546

Megjithatë, ngritja e padive është duke rënë në vazhdimësi. Në vitin 2018 kishim 20 padi, nga të cilat burojnë edhe shuma e lartë e detyrimeve kontingjente, ndërsa në vitin 2019 ka rënë në vetëm gjashtë (6) padi.

Rënia e padive drejtuar Fondit pasqyron rritjen e kontrollit në menaxhimin e shpenzimeve e përkatësisht në programin e Trajtimeve Mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore.

3. Programi i trajtimeve mjekësore jashtë ISHP-ve

3.1. Trajtimet mjekësore jashtë ISHP-ve

Programi për Trajtime Mjekësore Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP) është program i themeluar me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në kushtet kur Institucionet Shëndetësore Publike nuk mund të ofrojnë shërbime të tilla. Këto shërbime kryhen në institucione shëndetësore private brenda ose jashtë vendit. Funksionimi i këtij programi është i rregulluar me udhëzim administrativ në të cilin janë të parapara procedurat e përfitimit nga ky program si dhe organet për administrimin e programit.

Gjatë vitit 2019 kanë aplikuar 1,436⁴ paciente për programin TMJISHP, derisa numri i aprovimeve arrin në 1,312.

Nëse shihen në total, aplikimet në raport me aprovimet shihet se kanë mbetur edhe 124 lëndë të pa aprovuara, qoftë për shkak të procedurave administrative ose për shkak të kërkesave për kompletim të dokumentacionit.

Nëse i krahasojmë aplikimet dhe aprovimet e vitit 2019 krahasuar me të vitit 2018 shihet një trend përafërsisht i njëjtë i aplikimeve si dhe aprovimeve të lëndëve për këtë program.


Tabela nr.9. Kërkesat dhe lëndët e aprovuara për vitin 2019 dhe krahasimet me vitin 2018

Nr.	Përshkrimi	Aplikimet për vitin 2018	Aplikimet për vitin 2019	Diferenca
1	Aplikime	1,432	1,436	4
2	Raste urgjente	611	628	17
3	Raste të rregullta	821	808	-13
4	Aprovime	1,394	1,312	-82

Vlen të theksohet se në vitin 2019, për herë të parë është përmbushur numri i rasteve (100) për trajtim mjekësor falas sipas marrëveshjes me Turqinë. Megjithatë një numër i pacientëve (diku 13) për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të shkojnë për trajtim shëndetësor. Fondi ka kërkuar që të zëvendësohen me pacientë të ri, mirëpo kjo nuk është pranuar nga Turqia.

⁴ Në kuadër të aplikimeve për vitin 2019 përfshihen edhe rastet të cilat janë dërguar për trajtim mjekësor falas sipas marrëveshjes me Turqinë.

Figura nr.3. Kërkesat dhe lëndët e aprovuara për vitin 2019 dhe krahasimet më vitin 2018




Megjithatë nëse i shohim referimet sipas klinikave për programin e TMJISHP-ve, atëherë vërehen ndryshime të theksuara. Numri i referimeve është reduktuar dukshëm në Ortopedi, Kardiologji dhe Oftalmologji, mirëpo është rritur në disa klinika të tjera. Në tabelën në vijim janë shpalosur referimet sipas klinikave për vitin 2019 dhe 2018, si dhe diferencat mes tyre.

Tabela nr.10. Numri i aplikimeve për trajtime mjekësore të referuara sipas klinikave për vitin 2019

Nr.	Klinika	Numri i aplikimeve për vitin 2018	Numri i aplikimeve për vitin 2019	Diferenca
1	Oftalmologji	437	414	(23)
2	Pediatri	200	224	24
3	Ortopedi	240	135	(105)
4	Onkologji	97	108	11
5	Kirurgji torakale	22	61	39
6	Hematologji	58	95	37
7	Kardiologji	120	45	(75)
8	ORL	52	52	-
10	Urologji	27	37	10
11	Nenonatologji	23	36	13
12	Mjekësi nukleare	19	25	6
13	Neurologji	13	27	14
14	Kirurgji vaskulare	19	28	9
15	Nefrologji	20	21	1
17	Te tjera	85	128	43
Gjithsej		1,432	1,436	4

Figura nr.4. Aplikimet të referuara sipas klinikave për vitin 2019 në raport me vitin 2018



3.2. Pagesat për trajtimet mjekësore jashtë ISHP-ve

Pagesat për programin TMJISHP-ve për vitin 2019 ishin në vlerë 8,699,979€, ose mbi 92% e shpenzimeve totale të Fondit. Në tabelën në vijim janë shpalosur pagesat sipas vendeve ku janë kryer ato.


Tabela nr.11. Pagesat për TMJISHP-ve për vitin 2019 në raport me vitin 2018

Nr.	Vendi	Vlera e pagesave për vitin 2018	Vlera e pagesave për vitin 2019	Diferenca
1	Turqia	5,573,723	5,628,520	54,797
2	Kosova	1,272,259	1,232,385	(39,874)
3	Maqedonia	451,127	464,644	13,517
4	Gjermania	934,411	475,906	(458,505)
5	Shqipëria	500,511	471,231	(29,280)
6	Italia	243,972	152,026	(91,946)
7	Austria	60,153	74,813	14,660
8	Anglia	6,102	28,132	22,030
9	Kroacia	66,757	78,562	11,805
10	Amerika	64,673	30,000	(34,673)
11	Arabia	13,000	-	(13,000)
12	Çekia	5,865	-	(5,865)
13	Zvicra	-	28,527	28,527
14	Belgjika	-	14,015	14,015
15	Sllovenia	-	9,560	9,560
16	Franca	-	7,313	7,313
17	Izraeli	-	4,345	4,345
Gjithsej		9,192,553	8,699,979	(492,574)

Pjesa me e madhe e pagesave janë bërë për të mbuluar të gjitha obligimet e vitit 2018, si dhe disa raste të vitit 2019 të cilat ishin urgjente, rastet tjera kur pacienteve u është përkeqësuar gjendja shëndetësore, si dhe rastet urgjente të dërguara në vendet e Bashkimit Europian, të cilat nuk pranojnë të kryejnë trajtimin e pacientit pa u ekzekutuar pagesa, pavarësisht prezantimit të fletë-zotimit të lëshuar nga Fondi.

Në vijim paraqiten pagesat për trajtime mjekësore për vitin 2019 në formë grafike.

Figura nr.5. Pagesat për TMJIShP-ve për vitin 2019 në raport me vitin 2018



3.3. Procesi i barazimeve me spitalet private

Me vendimin e datës 23 shkurt 2019, Drejtori i Fondit ka themeluar Komisionin për Barazime Financiare ndërmjet Fondit dhe Institucioneve Shëndetësore Private brenda dhe jashtë vendit. Sipas vendimit, komisioni ka për obligim që të marrë në shikim, kontrollojë, dhe verifikojë tërë dokumentacionin në lidhje me secilën kërkesë individuale për programin TMJIShP, pavarësisht vendit ose kohës së realizimit të kërkesës. Dokumentacioni i pranuar do të verifikohet kundrejt të dhënave dhe informatave që komisioni ka në dispozicion dhe/ose do të pranojë nga ISHP-të brenda dhe jashtë vendit.

Sipas Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 13, Krijimi dhe mbajtja e regjistrave, pika 2. Pavarësisht nga kërkesat për mbajtjen e regjistrave të parashikuara në legjislacionet dhe udhëzimet e tjera administrative tatimore: 2.1. një person i cili ka detyrë të krijojë regjistra sipas këtij ligji do t'i mbajë ato regjistra për një periudhë prej së paku gjashtë (6) vjet pas përfundimit të periudhës tatimore kur ka lindur një detyrim i tillë tatimor përkatës.

Bazuar në këtë kërkesë, komisioni i themeluar për barazime ka përcaktuar periudhën 2013 – 2018, përkatësisht gjashtë (6) vite, në të cilën do të bëjë barazimin me spitalet dhe do t'i identifikojë mjetet e lira (rastet në të cilat është kryer pagesa mirëpo nuk janë përfunduar shërbimet shëndetësore, ose rastet tjera kur shërbimet e ofruara ishin me të ulëta në raport me pagesat).

Komisioni për barazime fillimisht ka përgatitur metodologjinë e punës përfshirë gjithë procesin nga përgatitja e kartelave e deri të nënshkrimi i raportit si dhe arkivimi i gjithë dokumentacionit. Me pas ka vijuar me përgatitjen e kartelave me secilin Institucion Shëndetësor brenda dhe jashtë vendit, si dhe me procesin e barazimeve.

Pasi që vëllimi më i madh i transaksioneve ishte me Institucionet Shëndetësore Private brenda vendit, komisioni ka vendosur t'i jap prioritet. Në kuadër të tyre, fillimisht janë marrë Institucionet Shëndetësore Private të cilat kanë numrin më të madh të transaksioneve.

Deri në fund të vitit 2019 janë barazuar 13 institucione me 740 transaksione dhe vlera e mjeteve të lira të dala nga ky proces është 383,222€⁵. Në vijim kemi prezantuar detajet për secilin prej tyre.

Tabela nr.12. Institucionet Shëndetësore Private me të cilat Fondi ka përfunduar barazimet

Nr.	Institucioni Shëndetësor Privat	Numri i shërbimeve	Vlera totale e pagesave	Vlera e mjeteve të lira
1	Klinika Gjermane e Syrit sh.p.k.	288	1,104,286	158,630
2	Qendra Laserike e Syrit - Kubati	341	875,478	197,518
3	Elab Kosova sh.p.k.	37	108,512	5,500
4	Prolab sh.p.k.	14	13,651	260
5	Akat Orthomedita	18	163,450	5,930
6	Tirana Lab	11	10,584	1,504
7	Otrila	4	13,225	2,795
8	Metropolis	1	840	-
9	Qendra Diagnostike Plus	2	765	-
10	CT Scanner	4	8,150	-
11	Italian Medical Center	4	62,409	-
12	Klinika Gjermane DFK	1	4,500	-
13	Ortoprotech	15	62,003	11,085
Gjithsej		740	2,427,853	383,222

⁵ Menaxhmenti i Fondit ka vendosur që këto mjete të shfrytëzohen për pacientet që janë në listën e pritjeve për pagesë.

Përpos 13 Institucioneve Shëndetësore Private të prezantuara në tabelën e lartcekur, komisioni i barazimeve është në proces të barazimeve edhe për 24 institucione të tjera me të cilat Fondi kishte 3,451 transaksione.

Tabela nr.13. Institucionet Shëndetësore Private me të cilat Fondi është në proces të barazimeve

Nr.	Institucioni Shëndetësor Privat	Numri i shërbimeve	Vlera totale e pagesave
1	Orthomedica	7	45,890
2	Klinika Amerikane	1	4,700
3	Sinorg	54	835,150
4	Lindja	1	3,500
5	Spitali Amerikan	855	3,994,690
6	Kavaja	101	241,735
7	Royal	164	519,478
8	Rezonanca	181	170,165
9	Eyo Hospital	184	594,694
10	Internacional Medicine Hospital	937	5,667,881
11	Cardio Center Shpk	34	81,700
12	Klinika Gjermane E Syrit Tirane	25	166,100
13	Spitali Amerikan Tirane	236	1,794,384
14	Eye European	149	591,520
15	Acibadem Sistina	181	856,375
16	Zan Mitrev	10	89,590
17	Filip Vtori	61	362,899
18	Remedika	11	29,750
19	Medical Park	55	1,308,049
20	Istinye	2	60,000
21	Acibadem Sistina- Turqi	91	1,025,855
22	Spitali Amerikan - Turqi	36	1,071,549
23	Koc University	18	375,623
24	Liv Hospital	57	2,472,182
Gjithsej		3,451	22,363,459

4. Parapërgatitja për kontraktimin e shërbimeve shëndetësore

Gjatë vitit 2019 Fondi ka realizuar një sërë aktivitete drejtë parapërgatitjes për kontraktimin e shërbimeve shëndetësore, si:

- Janë shqyrtuar kontratat nga vendet e regjionit (Mali i Zi dhe Kroacia);
- Janë përgatitur draft dokumentet për kontraktim dhe në momentin e hartimit të kornizës ligjore të nevojshme mund të shfrytëzohen si dokumente për finalizimin e kontratave;
- Krijimi i listës së shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor së bashku me deklaratën përkatëse financiare për vitin fiskal;
- Hartimi i termave të referencës për Komitetin Teknik dhe rregullores së punës për Komitetin Teknik;
- Themelimi i Komisioneve Profesionale sipas Klinikave të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës, hartimi i termave të referencës për Komisionet profesionale dhe rregullores së punës së këtyre komisioneve profesionale;
- Konstituimi i Komitetit Teknik dhe fillimi i punës së komisioneve profesionale. Definimi i Listës themelore është në proces edhe përkundër angazhimeve për shkak të problemeve organizative, mungesës së aktit nënligjorë për definimin e katalogut, etj.;
- Trajnimi i kryesuesve të Komisioneve profesionale për metodologjinë e punës gjatë identifikimit të shërbimeve nga ICD9;
- Takime koordinuese me përfaqësues të institucioneve shëndetësore private, me projekte si (Banka Botërore, Projekti i LuxDev-Muller Healthcare Consulting, etj.;
- Pjesëmarrja e rregullt dhe kontributi direkt në kuadër të Komisionit për Kostimin e Politikave (akteve nënligjore, strategjive, etj.) i themeluar me Vendim të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Pjesëmarrja e rregullt dhe kontributi direkt në kuadër të Komisionit për Adoptimin e ICD10 dhe ICD9 i themeluar me Vendim të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë; dhe
- Pjesëmarrja e rregullt dhe kontributi direkt në kuadër të Këshillit Kosovar për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike.

5. Shërbimet farmaceutike

Në vitin 2019, përkatësisht pas datës 25.02.2019, pas largimit të barnave nga buxheti i Fondit, Departamenti për Shërbime Farmaceutike, përmes Ligjit të Sigurimeve Shëndetësore, ka paraqitur një plan të ri të aktiviteteve në drejtim të përgatitjes dhe finalizimit të listës së barnave jashtë-spitalore (më çmime), të cilat do të paguheshin nga Fondi. Gjate vitit 2019, ky departament në bashkëpunim me Institucionet Shëndetësore ka realizuar aktivitetet si në vijim:

- Furnizimi i Shërbimit Spitalor, Klinik dhe Universitar të Kosovës me produkte nga Lista e Barnave Esenciale deri më datë 25.02.2019 kur është bërë edhe zyrtarisht pranim/dorëzimi i kontratave;
- Pjesëmarrje aktive në Komitetin Teknik për revidimin e Listës së Barnave Esenciale, ku pjesa e barnave është miratuar nga ana e Ministrit në shtator të vitit 2019 ndërkohë që vazhdojnë aktivitetet për revidimin e listave tjera konform rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë;
- Pjesëmarrje aktive në Grup Punues për ri-dizajnimin e Sistemit të Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF);
- Pjesëmarrje aktive në Grup Punues për hartimin e Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale;
- Pjesëmarrje aktive në Komisionin për përcaktimin e çmimeve të produkteve të regjistruara pranë Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
- Trajnime lidhur me hartimin e Udhërrëfyesve dhe Protokoleve Klinike;
- Pjesëmarrje në hartimin e Koncept Dokumentit për Produkte dhe Pajisje medicinale nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
- Pjesëmarrja në ekipin mbështetës për hartimin e Rregullores për marrëdhëniet kontraktuale me Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor;
- Pjesëmarrje në ekipin menaxhues të kontratës “Outpatient Drug Benefit Scheme”;
- Pjesëmarrje në ekipin mbështetës për hartimin/implementimin e modulit të e-Recetës; si dhe
- Përfitimi nga trajnimet lidhur me metodologjinë e përcaktimit të çmimeve “External and Internal Reference Pricing” nga kompania kontraktuese Conseil Sante.

Fondi në bashkëpunim me kompaninë implementuese të sistemit të Informimit të Fondit ka trajnuar 903 farmacistë për përdorimin e E-recetës (recetës elektronike).

6. Sistemet e informacionit

Departamenti i Menaxhimit të Teknologjisë së Informacionit është përgjegjës për krijimin e politikave, procedurave dhe planifikimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI), për prokurimin dhe kontratat e TI-së, për sigurimin e infrastrukturës harduerike dhe softuerike dhe automatizimin e proceseve për të gjitha sistemet të informacionit brenda Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Departamenti është përgjegjës edhe për planifikimin financiar, por edhe për të ofruar shërbime gjithëpërfshirëse që përmirësojnë dhe avancojnë proceset e teknologjisë së informacionit me kosto efektive. Po ashtu Departamenti është përgjegjës për të ofruar zgjidhje që mund të funksionojnë në mënyrë të pavarur duke ndihmuar njësitë operative në sigurimin e funksionaliteteve që u nevojiten. Pra, Departamenti i Menaxhimit të Teknologjisë së informacionit është përgjegjës për arkitekturën, harduerin, softuerin, rrjetin e kompjuterëve dhe politikat e procedurat për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Tre ekspertët e angazhuar në fund të vitit 2018 përmes projektit të Shëndetësisë Kosovare kanë qenë të angazhuar edhe gjatë vitit 2019, të cilët kanë ndihmuar Fondin në realizimin e aktiviteteve të parapara, por edhe aktiviteteve të reja që kanë dalë gjatë vitit.

Raporti pasqyron evoluimin e vazhdueshëm të misionit të TI-së dhe aktiviteteve të kryera nga departamenti për periudhën janar – dhjetor 2019.

Vizioni i Departamentit të Menaxhimit të Teknologjisë së Informacionit - *Teknologjia e nesërme, të shpërndahet sot.*

Misioni i Departamentit të Menaxhimit të Teknologjisë së Informacionit - *Sigurimi i teknologjisë së besueshme të informacionit me udhëheqje dhe shërbime të telekomunikacionit që ofrojnë zgjidhje të provuara dhe me kosto efektive për të gjithë punonjësit e brendshëm, por edhe për akterët e jashtëm.*

Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2019 - Çdo vit, departamenti i TI-së harton Planin e Punës për Teknologjinë e Informacionit duke përfshirë Planin e Infrastrukturës dhe Arkitekturës së sistemeve. Plani i punës përdoret për të ndihmuar në planifikimin e përpjekjeve të ardhshme të teknologjisë dhe paraqet në mënyrë të strukturuar të gjitha objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara për fushën e TI-së.


Në kuadër të Sistemeve të Informimit të Fondit është bërë vlerësimi i ofertave për zhvillimin e implementimin e Sistemit të Informimit të Fondit (HIFIS) dhe E-recetës përmes Projektit të Shëndetësisë Kosovare. Në fillim të muajt Maj është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik, e cila kontratë është përmbyllur me sukses në fund të vitit.

Në kuadër të kësaj kontrate është zhvilluar dhe implementuar E-receta dhe Sistemi Bazë i Informimit të Fondit i cili përmban disa module, E-receta, moduli i ndërlidhjes me institucione të tjera, moduli për menaxhimin e financave dhe kontabilitetit, moduli i raportimit, moduli për pagesat e premiumeve vullnetare. Në kuadër të këtij projekti janë dorëzuar edhe doracakët e përdorimit dhe është bërë trajnimi i 903 farmacistëve si dhe shfrytëzuesve tjerë. Për zhvillimin dhe implementimin e këtij sistemi janë kryer një numër i madh i aktiviteteve dhe ndërlidhjeve me sisteme të institucioneve të ndryshme, për shkëmbimin e të dhënave të ndryshme për kompletimin e bazës së të dhënave të Sistemit të Informimit të Fondit.

Figura nr.6 Institucionet me të cilat janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi



Figura nr.7 Pamje nga Sistemi i Informimit të Fondit



Në ambientet e qendrës së të dhënave në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), janë vendosur dhe konfiguruar serverët e Fondit, në të cilët është implementuar Sistemi i informacionit të Fondit (SIF/HIFIS). Në këta serverë janë krijuar tri ambiente, ambienti Production, Ambienti testues dhe Ambienti zhvillues.

Përmes resurseve të brendshme janë zhvilluar dhe implementuar disa aplikacione apo analizuar të dhëna, si:

- Ueb aplikacioni për raportimin e njësive shëndetësore nga tri nivelet (parësor, sekondar dhe tretësor) për numrin e vizitave, diagnozave, procedurave dhe kostove financiare (Raporti i punës, Raporti i kuadrit aktiv në kryerjen e punës dhe Raporti i shpenzimeve) në periudha mujore. Ky raportim bëhet për qëllime vlerësimi të shpenzimeve të procedurave në sistemin e përgjithshëm shëndetësor i cili do të mundësojë të kryhen veprime përgatitore, si vazhdimësi e punës në hartim të Draft çmimoreve të Listës Themelore të Shërbimeve Shëndetësore, llogaritjes së kostos reale të secilit shërbim. Po ashtu kjo paraqet një instrument kryesor në vlerësimin e punës, në funksionalizimin e veprimtarisë së Fondit, instrument që i paraprin mundësisë së krijimit të elementeve bazë për analizë të punës së Institucioneve Shëndetësore dhe krijimit të bazës për Kontraktim në mes të Fondit dhe institucioneve shëndetësore;
- Ueb aplikacioni për regjistrimin e kërkesave për programin e TMJIShP-ve. Aplikacioni është ndërlidhur me regjistrin civil për regjistrimet e kërkesave dhe ka një numër i konsiderueshëm të raporteve të cilat kanë lehtësuar procesin e vendimmarrjes, menaxhimit dhe raportimit;

- Ueb aplikacioni e-Recepsioni, për regjistrimin e vizitorëve në Fond, i cili është në shfrytëzim dhe ka mundësuar që të menaxhohen palët dhe të përcillen llojet e vizitave;
- Ueb aplikacioni i përkohshëm për planifikimin e aktiviteteve të planit të punës në Fond, raportimin e progresit dhe menaxhimin e aktiviteteve/nën-aktiviteteve;
- Ndërfaqja për evidentim të procedurave/shërbimeve shëndetësore nga komisionet profesionale të QKUK-se dhe nivelit parësor. Po ashtu, është ofruar përkrahje teknike për këtë pjesë të stafit. Qëllimi i këtij procesi ka qenë evidentimi i procedurave/shërbimeve që kryhen në institucionet publike shëndetësore, sipas katalogut *ICD9 vol.3 shqip*. Përveç evidentimit të shërbimeve, përmes kësaj ndërfaqeje janë marrë edhe disa informata shpesh në lidhje me secilin shërbim të evidentuar si: kohëzgjatja, vëllimi i atij shërbimi, kush e realizon dhe nëse është spitalor apo ambulator. Krejt kjo me qëllim të një vlerësimi financiar sa më të përafërt për planifikim të buxhetit në momentin që fillohet me mbledhjen e premieeve dhe ndarjet buxhetore për ofruesit e shërbimeve shëndetësore;
- Janë analizuar të dhënat e regjistrimit të qytetarëve të Kosovës dhe është përgatitur një raport për të gjeturat dhe rekomandimet për përmirësimin e të dhënave që kanë të bëjnë me krijimin e trungut të të siguruarve; dhe
- Janë analizuar të dhënat e regjistrimit të farmacistëve të licencuar së bashku me të dhënat e nevojshme për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, veçanërisht të dhënat për vendosjen e qasjes në aplikacionin e rimbursimit të barnave për skemën e përfitimeve të barnave ambulatorie. Të gjeturat dhe rekomandimet do të përcillen edhe tek Oda e Farmacistëve të Kosovës.

Në kuadër të departamentit janë kryer edhe në mori aktiviteteve të tjera si:

- Është hartuar procedura dhe politikat e TIK – për reagim ndaj incidenteve;
- Është hartuar propozimi për strategjinë e rekrutimit në kuadër të departamentit të TI-së;
- Është implementuar plani i krijimit të kopjeve rezervë për të gjitha bazat e të dhënave të sistemeve të informacionit në Fond;
- Është finalizuar plani i trajnimeve, resurseve njerëzore dhe financiare për departamentin e menaxhimit të sistemeve të informacionit në Fond, për vitin 2019;
- Është bërë inventarizimi i të gjitha pajisjeve ekzistuese të TI-së në Fond, njëkohësisht është aplikuar standardizimi i emërtimeve për pajisjet e TI-së të cilat janë vendosur në domenin qeveritar;

- Është krijuar File Server në të cilin ruhen dokumentet dhe të dhëna tjera të Fondit në mënyrë të centralizuar nga zyrtarët e Fondit me qasje specifike. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë të rregullt dhe kjo ndihmon në vazhdimësinë e biznesit;
- Është implementuar sistemi për video konferenca në sallën e takimeve të Fondit, i cili sistem ka lehtësuar takimet me palët e jashtme;
- Është implementuar platforma Office365, e cila mundëson që përdoruesit të punojnë nga kudo brenda rrjetit qeveritar, ka siguri dhe besueshmëri të fuqishme, dhe ekipet apo përdoruesit mund të bashkëpunojnë lehtësisht në mes vete;
- Është dizajnuar Intraneti i brendshëm i cili përdoret nga të gjithë zyrtarët e Fondit për qasje në Sistemet e Informacionit të Fondit. Kjo ka mundësuar qasje të centralizuar, përmirësim të komunikimit të brendshëm dhe ka ndihmuar punonjësit të gjejnë informacion në mënyrë më të shpejt dhe më të lehtë;
- Nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit janë bartur tek departamenti i TI-së qasjet e nevojshme administrative për menaxhimin e llogarive të zyrtarëve të Fondit. Kjo ka rritur efikasitetin duke zvogëluar kohën e pritjes në mënyrë drastike;
- Është implementuar sistemi i arkivit digjital për ruajtjen e dokumenteve elektronike të Fondit, i cili sistem ka lehtësuar menaxhimin, kërkimin dhe gjetjen me lehtësi dhe në mënyrë të shpejt të informacionit;
- Janë implementuar ndryshime në ueb faqen e Fondit duke vendosur informacion të freskët dhe duke e mirëmbajtur rregullisht;
- Janë dizajnuar koncepte vizuale për shabllonet e raporteve të ndryshme të Fondit dhe janë propozuar të menaxhmenti i Fondit, disa nga të cilat kanë filluar të përdoren. Kjo mundëson në krijimin e identitetit të raporteve;
- Me qëllim të promovimit sa më të mirë të Fondit janë krijuar faqet zyrtare të Fondit në rrjete sociale, të cilat vazhdimisht popullohen me të dhëna informuese;
- Janë përgatitur termat e referencës për "Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e Fondit dhe është shpallur tenderi;
- Me qëllim të komunikimit dhe shkëmbimit të dokumenteve me AOK gjerman, Departamenti i TI-së ka testuar dhe rekomanduar platformën për komunikim; dhe
- Është vazhduar me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha pajisjeve dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit në kuadër të Fondit.

7. Asistenca e jashtme

Gjatë kësaj periudhe Fondi ka përfituar mbështetje nga marrëveshjet e lidhura në mes të Ministrisë së Shëndetësisë me bankën Botërore, AOK dhe Lux-Dev. Në vijim të raportit po shpalosim përfitimet nga marrëveshjet e lidhura.

7.1. Projekti i Shëndetësisë Kosovare

Projekti i Shëndetësisë Kosovare ka siguruar përkrahje në definimin dhe zbatimin e pakos përfituese të Sigurimeve Shëndetësore. Pakoja përfshinë shërbimet e kujdesit shëndetësor që do të rimbursohen nga Fondi. Fillimisht fokusi ishte në barnat jashtë-spitalore të ofruara përmes barnatoreve private. Kjo nën-komponentë do të përfshijë asistencën teknike për të ndihmuar në konsultimet me grupet kyçe të interesit dhe përfituesit kryesor, si dhe përkrahje në përgatitjen e raporteve teknike, politikave dhe akteve nënligjore, si dhe në procesin e vendimmarrjes që do të ndihmojë në adoptimin e pakos. Këtu po ashtu do të përfshihet edhe përkrahja teknike për Fondin në menaxhimin e skemës së përfitimit të barnave jashtë-spitalore gjatë fazave fillestare të zbatimit.

Banka Botërore përmes projektit të Shëndetësisë Kosovare ka të angazhuar pesë (5) ekspertë të cilët mbulojnë Financat, Legjislacionin, dhe TI-në.

Projekti i Shëndetësisë Kosovare ka siguruar përkrahje në dizajnimin, zhvillimin dhe shfrytëzimin e Sistemit të Informimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore (SIFSSH), përfshirë edhe një softuerë adekuat, duke u fokusuar në modulet që janë qenësorë për zbatimin e skemës së barnave jashtë-spitalore që do të ofrohen përmes barnatoreve private (modulet do të përfshijnë data-bazën e pacienteve, regjistrin e recetave, sistemin e pagesës, funksionet menaxhuese, buxhetin, menaxhimi financiar dhe resurset njerëzore).

Projekti i Shëndetësisë Kosovare ka kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve të Fondit, si blerës i shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Këtu përfshihet asistenca teknike për Fondin në përgatitjen e buxhetit dhe dokumenteve financiare, zhvillimi i funksionit të monitorimit të financimit shëndetësor, definimi i proceseve menaxhuese që lidhen me blerjen e mallrave dhe shërbimeve shëndetësore. Përveç kësaj, kjo nën-komponentë ka mbështetur edhe krijimin e kushteve adekuate për punë (inventar dhe pajisje për zyre, trajnime, aranzhimi i binjakëzimeve dhe vizitave studimore, përkrahja teknike etj.).

7.2. AOK

Bashkëpunimi midis Fondit të Sigurimeve Shëndetësore të Kosovës dhe Fondit të Sigurimit Gjerman, AOK, ka filluar në muajin janar të vitit 2020, si rezultat i memorandumit të përbashkët të mirëkuptimit që u nënshkrua në korrik të vitit 2019 në mes të Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës dhe asaj të Gjermanisë.

Përmes kësaj marrëveshje AOK do të ndihmojë Fondin të ngritë kapacitetet e tij profesionale. Ky bashkëpunim përfshinë një mori procesesh, si: definimin dhe sqarimin e statutit të të siguruarit, sqarimin e procesit të mbledhjes së premiumeve dhe të hyrave tjera të gjeneruara, definimin e listës së barnave që do të rimbursohen nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, llojet e sëmundjeve të mbuluara dhe grupet që do të përfitojnë, sqarime dhe mbështetje në legjislacion, definimi i benifiteve/përfitimeve për të siguruarit pas fillimit të mbledhjes së premiumeve, etj.

Në këtë fazë të mbështetjes teknike dhe profesionale janë shtjelluar çështje që ndërlidhen me statusin e të siguruarve të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, modalitetet e grumbullimit të kontributeve, si dhe para llogaritjen dhe balancimin e të hyrave dhe shpenzimeve të Fondit.

7.3. Lux-Dev

Nga Lux-Dev (Kompania konsulente nga Luxembourg Muller Healthcare Consulting) Fondi ka filluar të marrë mbështetje në:

- Sistemin e alokimit të financave bazuar në aktivitete;
- Implementimin e një sistemi të raportimit sipas DRG-së; dhe
- Vlerësimin e zbatimit të sistemit të financimit të bazuar në kapitacion për kujdesin shëndetësor parësor.

Shtojca I – Objektivat dhe aktivitetet për vitin 2019

Objektivat për vitin 2019	Numri i nën-aktiviteteve të planifikuara	Numri i nën-aktiviteteve të realizuara dhe në proces	Shkalla e realizmit të planit të punës
Objektiva 1 - Sigurimi i një qeverisje efektive, transparencë dhe llogaridhënia në Fond.	26	26	100%
Objektiva 2 - Përgatitja e planit për zhvillim institucional tre (3) vjeçar dhe planit vjetor të punës për vitin 2020.	7	7	100%
Objektiva 3 - Identifikimi i nevojave për plotësim /ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe procedurave të brendshme administrative si dhe iniciimi i tyre për kompletimin e legjislacionit.	11	7	64%
Objektiva 4 - Zhvillimi dhe implementimi i sistemeve.	19	19	100%
Objektiva 5 - Implementimi i Sistemit të Informimit të Fondit.	21	21	100%
Objektiva 6 - Bashkëpunimi me SHSKUK, KPSH dhe Institucionet tjera të kujdesit shëndetësor. Parapërgatitja për kontraktimin e shërbimeve shëndetësore.	5	2	40%
Objektiva 7 - Menaxhimi efikas i trajtimeve mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore.	4	4	100%
Objektiva 8 - Ngritja e bashkëpunimit me Institucionet tjera vendore si dhe me partneret ndërkombëtar.	6	5	83%
Objektiva 9 - Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore si dhe edukimi i vazhdueshëm profesional.	6	4	67%
Objektiva 10 - Plotësimi i parakushteve për kontraktim të shërbimeve si dhe fillimin e mbledhjes së premive sipas ligjit Nr. 04/L -249 për Sigurimin Shëndetësor.	21	14	67%
Objektiva 11 - Përgatitja dhe finalizimi i listës së barnave jashtë-spitalore (më çmime) të cilat do të paguheshin nga Fond.	5	0	0%
Objektiva 12 - Njoftimi i publikut përmes kampanjave informuese dhe rritja e besimit nga ana e publikut.	11	6	55%
Objektiva 13 - Sigurimi i lokacionit/fillimi i ndërtimit të objektit të Fondit për Sigurime Shëndetësore.	6	3	50%
Gjithsej	148	118	80%

Në vitin 2019 janë realizuar 118 nën-aktivitete nga 148 të planifikuara ose 80% e planit vjetor janë (nën-aktivitetet e realizuara dhe ato në proces). Realizimi me i ulët i planit është te pesë (5) objektiva, përkatësisht të objektivat si në vijim:

- **Objektiva 3** – nga 11 nën-aktivitete të planifikuara në kuadër të kësaj objektive shtatë (7) janë realizuar gjatë vitit 2019 ose 64%. Nën-aktivitetet e parealizuara ndërlidhen kryesisht me dhënien e kontributit në hartimin e rregulloreve të reja të cilat janë të nevojshme për plotësimin e legjislacionit sekondar të Fondit, si dhe krijimin e procedurave të brendshme administrative, përfshirë doracakët për udhëzimin e të punësuarve për punë;
- **Objektiva 6** – nga pesë (5) nën-aktivitete të planifikuara në kuadër të kësaj objektive vetëm dy (2) janë realizuar gjatë vitit 2019 ose 40%. Nën-aktivitetet e parealizuara ndërlidhen kryesisht me procedurat për kontraktim dhe definimin e modelit të kontratës për shërbime shëndetësore. Mos realizimi i nën-aktiviteteve ndërlidhet me vonesat në rishikimin e bazës ligjore për kontraktim dhe definimin e modelit të kontratës për shërbime shëndetësore;
- **Objektiva 11** – asnjë nga pesë (5) nën-aktivitetet e planifikuara në kuadër të kësaj objektive nuk janë realizuar gjatë vitit 2019. Ketë e ka shkaktuar mungesa e rishikimit të legjislacionit (Ligjit të Sigurimeve Shëndetësore dhe Akteve Normative për kontraktimin e barnatoreve);
- **Objektiva 12** – Nga 11 nën-aktivitete të planifikuara në kuadër të kësaj objektive gjashtë (6) janë realizuar gjatë vitit 2019 ose 55%. Nën-aktivitetet e parealizuara ndërlidhen kryesisht me përgatitjen e materialeve të nevojshme (broshurave, seminareve, spoteve, njoftimeve në faqen elektronike, etj), si dhe organizimin e kampanjave informuese. Mos realizimi i nën-aktiviteteve ndërlidhet me vonesat në rekrutimin e stafit në zyrën për informim si rrjedhojë e procedurave të ankesave; dhe
- **Objektiva 13** – Nga gjashtë (6) nën-aktivitete të planifikuara në kuadër të kësaj objektive tri (3) janë realizuar gjatë vitit 2019 ose 50%. Nën-aktivitetet e parealizuara ndërlidhen me procedurat për nderimin e objektit të Fondit. Mos realizimi i nën-aktiviteteve ndërlidhet me vonesat në përcaktimin e parcelës së tokës.

Shtojca II – Pasqyrat financiare për vitin 2019

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

Neni 12 DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: AHMET ISMAILI, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Nga: z. Fatmir Plakiqi_____, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)

z. Liridon Dervishaj_____, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2019.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
